VENDIM
Nr. 142, datë 28.8.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 72, DATË 22.4.2020, "MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË 'GREEN ENERGY TRADING ALBANIA' SHPK, NR. 286, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 59, DATË 23.4.2015"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/1 prot., datë 19.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., mbi plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 72, datë 22.4.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 72, datë 22.4.2020, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., nr. 286, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015", vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nr. 286, seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 59, datë 23.4.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.4.2020.

2. Shoqëria "Green Energy Trading Albania" sh.p.k. të depozitojë në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë COVID-19, vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, germa "d" të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 657 prot., datë 22.4.2020, u njoftua shoqëria "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., në lidhje me vendimmarrjen e ERE-s për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, nr. 657/1 prot., datë 16.7.2020, u njoftua shoqëria në lidhje me detyrimin për të depozituar në ERE, jo më vonë se një muaj nga përfundimi i pandemisë COVID-19, dokumentacionin e munguar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 657/2 , datë 22.7.2020, shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimet nga Gjykata dhe Prokuroria, nga të cilat rezulton se ndaj administratorit të shoqërisë nuk rezulton të ketë procedim penal apo proces gjyqësor të regjistruar në ngarkim të tij.

- Shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe të Prokurorisë për përfaqësuesin ligjor të saj, nga të cilat rezulton se nuk ka procedim penal apo proces gjyqësor të regjistruar në ngarkim të tij.

- Rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtet e vendosura në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72, datë 22.4.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikës 2, të vendimit nr. 72, datë 22.4.2020, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., nr. 286, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të licencuarin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti